

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

PROGRAMI CIVIL DHE PRONËSOR



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Transaksionet jo formale pronësore në Kosovë nga këndvështrimi ligjor dhe i praktikës
gjyqësore

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Qerkin Berisha

Kandidate:

Blenda Gashi

Prishtinë, Qershor 2021

Abstrakt

E drejta e pronësisë është e drejtë themelore e njeriut, është e drejtë absolute subjektive, sendore dhe si e tillë gëzon mbrojtje juridike. Mbrojtja juridike e të drejtës së pronësisë shtrihet si në nivelin nacional ashtu dhe në atë ndërkombëtarë.

Titullari i të drejtës së pronësisë ka disa autorizime të cilat nuk mund të mohohen apo kufizohen nga askush, përveç në rastet e parapara me ligj. Një ndër autorizimet që i ka pronari në sendin e tij është edhe tjetërsimi apo bartja e pronësisë tek një person tjetër. Edhe pse mënyra e bartjes së pronësisë është e rregulluar me ligj, në zbatimin e saj në praktikë ka qalime të shumta. Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë shoqërore, ekonomike, juridike të kësaj problematike, temë për punim masteri zgjedha transaksionet jo formale pronësore në Kosovë, duke analizuar si nga këndvështrimi ligjor ashtu edhe ai i praktikës gjyqësore.

Nëpërmjet këtij punimi synohet të vëhen në pahë zbrastësitë ligjore dhe veprimi i praktikës gjyqësore. Në fokusin tim përveç analizimit të rregullativës ligjore, vend kyresor zë praktika gjyqësore në Kosovë. Rëndësi të veçantë i është kushtuar formave të vërtetimit të së drejtës së pronësisë në Gjykatat e Kosovës, shqyrtimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastet e pretendimeve për shkelje të të drejtës së pronësisë, nxjerrja e Aktgjykimeve pohuese në kontestet pronësore si dhe vërtetimi i të drejtës së pronësisë përmes insitutit të parashkrimit fitues.

Ndër të tjera, duke krahasuar regjistrat e aktgjykimeve për vërtetim pronësie në Gjykatat e Kosovës dhe regjistrat për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri, do të shohim efektin konstituiv të regjistrimit të së drejtës së pronësisë. Përveç kësaj, duke krahasuar regjistrat e gjendjes civile të të vdekurve konkretisht në komunën e Suharekës dhe inicimin e procedurave trashëgimore në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë, si dhe tek dy noterët në Suharekë, shohim se sa respektohet dhe ndiqet kjo procedurë. Andaj, analiza e bërë gjatë këtij punimi tregon edhe më mirë se sa e rëndësishme është zgjidhja e këtyre problematikave.

Fjalët kyçe: pronësia, transaksionet jo formale pronësore, parashkrimi fitues, aktgjykimet pohuese, praktika gjyqësore, etj.